



Mali i Zi / Crna Gora
Komuna e Tuzit / Opština Tuzi

Sekretariati për vetëqeverisje lokale
Sekretarijat za lokalnu samoupravu

Komisija za raspodjelu sredstava NVO
Nr./Br. 04-056/24-2434/3

Rruga Tuz nr. 1 , nr. 44
Ulica Tuzi br.1 , br. 44

+382 20 875 167
veteqeverisje.lokale@tuzi.org.me

Komisioni për ndarjen e mjeteve OJQ
Tuz – Tuzi, 19.04.2024. godine

Komisioni për ndarjen e mjeteve organizatave joqeveritare, në bazë të nenit 28 paragrafi 8 i Vendimit mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën e shpërndarjes së mjeteve organizatave joqeveritare (“Fleta zyrtare e Malit të Zi- dispozitat komunale” numër 046/19, 010/21, 016/21), sjell,

VENDIM

Për zgjedhjen e vlerësuesve të pavarur

1. Për vlerësuesin e pavarur për pikëzimin e projekteve të organizatave joqeveritare për vitin 2024 në komunën e Tuzit përcaktohen:
 - Saida Čikić;
 - Jadranka Rakonjac.
2. Detyra e vlerësuesve të pavarur është të vlerësojnë projektet, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Vendimin mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën e shpërndarjes së mjeteve organizatave joqeveritare.
3. Plotësimi i listës për vlerësimin e projekt propozimeve.
4. Dorëzimi i listës së projekt propozimeve e cila do të mbështetet nga komisioni.
5. Kompensimi për punën e vlerësuesve të pavarur do të përcaktohet me akt të veçantë.

Arsyetimi

Komisioni për ndarjen e mjeteve organizatave joqeveritare shpalli thirrjen publike për përzgjedhjen e vlerësuesve të pavarur për vitin 2024, numër 04-056/24-719/5 prej më 14.03.2024. Në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2024, komisioni nga kandidatët e paraqitur për vlerësues të pavarur për vlerësimin e projekteve të organizatave joqeveritare për vitin 2024 zgjodhën: Saida Čikić dhe Jadranka Rakonjac.

Neni 28 paragrafi 2 i Vendimit mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën e shpërndarjes së mjeteve organizatave joqeveritare (“Fleta zyrtare e Malit të Zi- dispozitat komunale” numër 046/19, 010/21, 016/21), përcakton se në procesin e vlerësimit të projekt propozimeve angazhohen dy ose më shumë vlerësues të pavarur, kurse neni 28 paragrafi 5 i të njëjtit vendim, përcakton që vlerësuesit e pavarur kanë të drejtë në kompensim për punën e tyre, i cili do të përcaktohet me akt të veçantë.

Vendimi për përzgjedhjen e vlerësuesve të pavarur do të publikohet në ueb faqen e Komunës së Tuzit.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kryetarja e komisionit,
Marina Ujkaj

